



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

**KORNIZA E PËRMBLEDHUR**

**E**

**PROGRAMIT KOMBËTAR**

**TË ZHVILLIMIT PROFESIONAL TË MËSUESVE**

**2024-2025**

## TABELA E PËRMBAJTJES

TABELA E PËRMBAJTJES .....	2
I. HYRJE .....	3
II. NEVOJA PËR HARTIMIN E PROGRAMIT .....	4
III. QËLLIMI DHE RISITË E PROGRAMIT .....	5
Qëllimi i programit .....	5
Risitë që shoqërojnë programin kombëtar të zhvillimit profesional të mësuesve .....	5
Objektivat e programit .....	5
Rezultatet e pritshme të programit .....	6
IV. KUJT I ADRESOHET PROGRAMI? .....	7
V. ZBATIMI I PROGRAMIT .....	8
Komponentët e programit .....	8
Fazat e zbatimit të programit .....	8
Skema e zbatimit të trajnimeve nga institucionet .....	9
Skema e monitorimit të programit .....	9
VI. KURRIKULA E TRAJNIMIT PËR SECILIN NGA KOMPONENTËT E PROGRAMIT .....	10

## I. HYRJE

Në një sistem arsimor gjithnjë e në zhvillim, roli i mësuesve i kapërcen kufijtë e tradicionales. Mësuesit e sotëm kanë për detyrë jo vetëm të japin njohuri, por edhe të kultivojnë mendimin kritik në gjuhë, matematikë, shkencë dhe aftësi digjitale. Përfaqimi i kësaj sfide dinamike kërkon një përkushtim ndaj të mësuarit gjatë gjithë jetës, duke e bërë zhvillimin e vazhduar profesional domosdoshmëri për çdo mësues.

Zhvillimi i vazhduar profesional në fushat: Gjuhë, Matematikë, Shkenca dhe Aftësi digjitale nuk është thjesht një detyrim profesional, por është një udhëtim transformues. **STEM** si qasje arsimore ndërdisiplinore integron katër fusha: Shkencë, Teknologji, Inxhinieri dhe Matematikë duke nxitur të menduarit kritik, aftësitë për zgjidhjen e problemeve, kreativitetin, të mësuarit praktik dhe zbatimet në botën reale.

**Revolucioni digjital** ka riformuar paradigmen arsimore, duke i bërë aftësitë digjitale një aspekt integral i mësimdhënies bashkëkohore. ZHVP në aftësitë digjitale i pajis mësuesit me mjetet për të integruar teknologjinë në orët mësimore, duke krijuar mjedise mësimore ndërvepruese dhe tërheqëse.

Në këtë kontekst është i domosdoshëm bashkimi i të gjitha burimeve institucionale dhe njerëzore në mënyrë që të sigurohet pajisja e mësuesve me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të përballuar sfidat e kohës dhe për të ofruar një arsim cilësor për nxënësit. Kjo mund të arrihet me anë të një programi kombëtar për zhvillimin profesional të mësuesve, në të cilën përcaktohen qartë objektivat dhe rezultatet e pritshme, adresohen të gjitha nevojat për trajnim dhe ndahen rolet dhe përgjegjësitë për çdo institucion.

Programi Kombëtar i Zhvillimit Profesional të Mësuesve 2024-2025, (më poshtë Programi) **synon të krijojë një mjedis arsimor dinamik dhe gjithëpërfshirës**, ku mësuesit janë udhëheqës në formimin e një brezi të ri nxënësish të përgatitur për shekullin XXI. Ai do të realizohet përmes bashkëpunimit dhe bashkërendimit të ekspertizës dhe kapaciteteve të disa institucioneve të përfshira në program për koordinimin e aktiviteteve, zhvillimin e trajnimeve, mentorimeve për mbështetjen e mësuesve

## II. NEVOJA PËR HARTIMIN E PROGRAMIT

Sigurimi i cilësisë në arsim dhe rritja e profesionalizimit të mësuesve udhëheqin gjithë angazhimin institucional të MAS-it në kuadër të prioriteteve të saj dhe përmbushjes së Strategjisë Kombëtare të Arsimit 2021-2026. Të gjitha hulumtimet tregojnë se cilësia e mësimdhënies është faktor përcaktues për arritjet e nxënësve.

Nevoja për hartimin e Programit lidhet me:

- Sigurimin e cilësisë në arsim. Investim në përditësimin e kurrikulës, zhvillimin profesional të mësuesve dhe mekanizma për monitorimin e cilësisë.
- Përmirësimi i mësimdhënie - nxënies. Mësues të pajisur me aftësi të përparuara pedagogjike dhe aftësi të përmirësuara në vlerësimin e nxënësit.
- Rritja e profesionalizimit të mësuesve. Mësues të zhvilluar profesionalisht nëpërmjet metodologjive praktike dhe inovatore në fushat e gjuhës shqipe, matematikës, shkencave dhe teknologjisë.
- Rezultatet në vlerësimet kombëtare dhe ndërkombëtare. Instrumente që duhen përdorur për përmirësimin e arritjeve të nxënësve.
- Inovacioni. Nxitja e inovacionit nëpërmjet pajisjes së mësuesve me aftësi digjitale dhe integritit të teknologjisë në mënyrë efektive në praktikat e mësimdhënies.
- Arsimi gjithëpërfshirës. Motivim i barazisë dhe i përfshirjes nëpërmjet adresimit të nevojave të nxënësve, aksesit të barabartë dhe mbështetjes për rezultate progresive.

### III. QËLLIMI DHE RISITË E PROGRAMIT

#### Qëllimi i programit

Qëllimi i programit kombëtar të zhvillimit profesional të mësuesve 2024-2025, është *përmirësimi i rezultateve të të nxënësve* përmes zhvillimit profesional të mësuesve, të koordinuar dhe të institucionalizuar me të gjithë aktorët në fushën e arsimit me fokus të lexuarit, matematikën, shkencat e natyrës, aftësitë digjitale, gjithëpërfshirjen dhe aftësitë efektive.

#### Risite që shoqërojnë programin kombëtar të zhvillimit profesional të mësuesve

1. Sistem i ri i trajnimit dhe kualifikimit të mësuesve.
2. Portofol digjital i mësuesit.
3. Platformë interaktive trajnimi.
4. Role të reja të mësuesit në shkollë.
5. Vlerësim i performancës së shkollës, mësuesve dhe nxënësve.

#### Objektivat e programit

Objektivat e përgjithshëm të programit janë:

- *Përmirësimi dhe rritja e cilësisë së arsimit parauniversitar duke rritur standardin arsimor* nëpërmjet përafrimit të metodologjisë së mësimdhënies me qasjen STEM.
- *Përmirësimi i performancës së nxënësve* nëpërmjet ngritjes së kapaciteteve të mësuesve për të zbatuar metoda që rrisin aftësitë e nxënësve në zhvillimin e mendimit kritik dhe zgjidhjes problemore.
- *Nxitja e inovacionit* nëpërmjet pajisjes së mësuesve me aftësi digjitale që u mundësojnë atyre të integrojnë teknologjinë në mënyrë efektive në praktikën e mësimdhënies.
- *Zhvillimi profesional i mësuesve* nëpërmjet sigurimit të mbështetjes së nevojshme për ngritjen e kapaciteteve që ata të qëndrojnë të përditësuar me praktikën dhe metodologjitë më të mira, në funksion të përmirësimit të mësimdhënies dhe rezultateve të nxënësve.
- *Lidhja e mësimdhënies me vlerësimin* për të aftësuar mësuesit në interpretimin e të dhënave të vlerësimit formues të nxënësve në mënyrë efektive, në përdorimin e tyre si një mjet për të përshtatur metodat e mësimdhënies, si dhe në adresimin e nevojave për të përmirësuar arritjet e të nxënësve.

- **Motivimi i barazisë dhe i përfshirjes** nëpërmjet adresimit të nevojave të nxënësve, sigurimit që të gjithë të kenë akses të barabartë në arsimin cilësor, si dhe mbështetje për rezultate progresive.
- **Vendosja e treguesve të qartë cilësorë** për monitorimin dhe për vlerësimin e performancës së nxënësve.

## **Rezultatet e pritshme të programit**

Rezultatet e pritshme nga zbatimi i programit kombëtar të zhvillimit profesional të mësuesve 2024-2025 janë transformuese dhe mund të përmbliidhen si më poshtë:

- ✓ **Zbatimi i metodave të mësimdhënies sipas qasjes STEM:** Harmonizimi i metodologjive të mësimdhënies me metodat interaktive, duke çuar në një sistem arsimor më efektiv.
- ✓ **Kompetenca e mësimdhënies e përmirësuar:** Mësues të pajisur me aftësi të përparuara pedagogjike dhe aftësi të përmirësuara në vlerësimin e nxënësit, duke rezultuar në metoda dhe qasje më efektive të mësimdhënies.
- ✓ **Integrimi digjital në mësimdhënie:** Mësues të aftë për të integruar mjetet digjitale në mënyrë efektive në praktikat e tyre të mësimdhënies, duke rritur angazhimin dhe rezultatet e të nxënit në klasë.
- ✓ **Performanca e përmirësuar mësimore:** Nxënësit kanë performancë më të mirë në fushat Gjuhë shqipe, Matematikë dhe Shkenca duke zhvilluar të menduarit kritik, zgjidhjen problemore dhe aftësitë në botën reale.
- ✓ **Aftësitë digjitale të përmirësuara:** Nxënësit demonstrojnë njohuri dhe aftësi të përmirësuara digjitale, duke përdorur teknologjinë në mënyrë efektive për të mësuar dhe për të zgjidhur probleme.
- ✓ **Zhvillimi holistik:** Nxënësit shfaqin rritje holistike jo vetëm në performancën mësimore, por edhe në kompetencat për të nxënit gjatë gjithë jetës.
- ✓ **Praktikat e arsimit gjithëpërfshirës:** Promovimi i praktikave gjithëpërfshirëse që plotësojnë nevojat e ndryshme të nxënësve, duke siguruar një mjedis të barabartë mësimi për të gjithë.

## IV. KUJT I ADRESOHET PROGRAMI?

Programi kombëtar i zhvillimit profesional të mësuesve u drejtohet “aktorëve” të ndryshëm të përfshirë në sektorin e arsimit, duke synuar të sjellë përmirësime në metodologjitë e mësimdhënies, pedagogjinë dhe standardet e përgjithshme arsimore. Këto palë të interesuara përfshijnë:

- ☞ **Mësuesit:** Përfituesit kryesorë të një programi të tillë janë vetë mësuesit, për të rritur aftësitë e tyre në mësimdhënie, për të prezantuar qasje inovative pedagogjike dhe për t'i mbajtur ata të përditësuar me praktikatat më të fundit arsimore.
- ☞ **Drejtuesit e shkollave:** Drejtuesit e shkollave mund ta përdorin këtë program për të nxitur një kulturë të të mësuarit dhe të përmirësimit të vazhdueshëm brenda institucioneve të tyre që mbështet rritjen profesionale të stafit mësimdhënës.
- ☞ **Trajnerët, drejtuesit e rrjeteve profesionale:** Individët e përfshirë në trajnimin e mësuesve, qofshin ata pedagogë në IAL, specialistë të arsimit, drejtues të rrjeteve profesionale të mësuesve, drejtues shkollash, drejtues të ekipeve kurrikulare përfitojnë nga programi për të përmirësuar teknikat e tyre të trajnimit dhe për të qenë të përditësuar me praktikatat më të fundit arsimore.
- ☞ **Ofruesit e trajnimeve të punonjësve arsimorë:** IAL-të që akreditojnë module për trajnimin e mësuesve, mund të shfrytëzojnë programin kombëtar të zhvillimit profesional për të bashkëpunuar, për të shkëmbyer burimet dhe për të përhapur ekspertizën e tyre në një audiencë më të gjerë mësuesish.
- ☞ **Partnerët:** Partnerët strategjikë e përdorin këtë program për të ofruar ekspertizë, mbështetje financiare, mjete, burime dhe materiale arsimore për realizimin e trajnimeve.
- ☞ **Nxënësit dhe prindërit:** Ndonëse nuk janë pjesëmarrës të drejtpërdrejtë në trajnim, nxënësit dhe prindërit kanë interes në cilësinë e arsimit dhe në përmirësimin arritjeve të nxënësve.

## V. ZBATIMI I PROGRAMIT

### Komponentët e programit

Programi kombëtar i zhvillimit profesional të mësuesve 2024-2025, përmban shtatë komponentë sipas fushave të mëposhtme:

1. Trajnimi i mësuesve të lëndëve: *Gjuhë shqipe, Matematikë dhe Shkenca (Fizikë, Biologji, Kimi)* për metodologjitë e mësimdhënies interaktive sipas qasjes STEM, si dhe ngritja e kapaciteteve të mësuesve për vlerësimin ndërkombëtar PISA.
2. Trajnimi i mësuesve të arsimit fillor në lëndët: *Gjuhë shqipe, Matematikë dhe Dituri natyre* për metodologjitë e mësimdhënies interaktive sipas qasjes STEM, si dhe ngritja e kapaciteteve të mësuesve për vlerësimin ndërkombëtar TIMSS, PIRLS.
3. Trajnimi i mësuesve të arsimit fillor për përmirësimin e aftësive së kodimit dhe të aftësive digjitale të nxënësve në shkollat e pajisura me SmartLab.
4. Trajnimi i mësuesve të arsimit të mesëm të ulët për realizimin e sondazhit ndërkombëtar TALIS për zhvillimin profesional të mësuesve.
5. Trajnimi i mësuesve të arsimit të mesëm të ulët për larminë e veprimtarive në lidhje me përmirësimin e orientimit për karrierë të nxënësve drejt arsimit të mesëm.
6. Trajnimi i mësuesve të arsimit parauniversitar për përmirësimin e metodologjisë gjatë orës së mësimin në lidhje me teknikat gjithëpërfshirëse.
7. Trajnimi i mësuesve të arsimit parauniversitar për aftësitë efektive të mësuesit si: *zgjidhja e konflikteve dhe aftësitë e komunikimit.*

### Fazat e zbatimit të programit


Zhvillimi dhe zbatimi i programit kombëtar të zhvillimit profesional 2024-2025 është një proces kompleks që përfshin aktorë dhe faza të ndryshme.

- ✓ **Zhvillimi i përmbajtjes:** Hartohet kurrikula e detajuar e trajnimit që adreson nevojat dhe rezultatet e pritshme të identifikuara në komponentin përkatës.
- ✓ **Zbatimi i komponentit:** Përgatitet plani i detajuar i komponentit në fushën përkatëse, garantohen burimet, logjistika, kapacitetet njerëzore për trajnimet.
- ✓ **Realizimi i trajnimeve:** Kryhet trajnimi nga IAL-të lidhur me metodologjitë e mësimdhënies interaktive.




- ✓ **Sigurimi i cilësisë:** Sigurohet cilësi gjatë realizimit të trajnimeve, nëpërmjet vlerësimeve të pjesëmarrësve në përfundim të veprimtarive përkatëse, si dhe mentorimeve për përmbushjen cilësore të rezultateve të pritshme të trajnimit.
- ✓ **Monitorimi dhe vlerësimi:** Planifikohen veprimtari për monitorime lidhur me vlerësimet performancës së mësuesve dhe nxënësve.

### Skema e zbatimit të trajnimeve nga institucionet



### Skema e monitorimit të programit



## VI. KURRIKULA E TRAJNIMIT PËR SECILIN NGA KOMPONENTËT E PROGRAMIT

Në programin kombëtar të zhvillimit profesional të mësuesve 2024-2025, “*Fuqia transformuese e zhvillimit të vazhdueshëm profesional për mësuesit në fushat: Gjuhë shqipe, Matematikë, Shkenca dhe Teknologji (STEM)*”, prezantohet kurrikula për secilin nga shtatë komponentët:

**KOMPONENT 1.** Trajnimi i mësuesve të lëndëve: *Gjuhë shqipe, Matematikë dhe Shkenca (Fizikë, Biologji, Kimi)* për metodologjitë e mësimdhënies interaktive sipas *qasjes STEM*, si dhe ngritja e kapaciteteve të mësuesve për vlerësimin ndërkombëtar PISA.

- ✗ Përfituesit: 10000 mësues të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë për të gjithë periudhën e programit.
- ✗ Kohëzgjatja e komponentit: 1,5 vjet (2024 – 2025)
- ✗ Kurrikula e përmbledhur e trajnimit: 16 module trajnimi gjithsej të ndara sipas fushave specifike: *Gjuhë shqipe, Matematikë dhe Shkenca (Fizikë, Biologji, Kimi)*
- ✗ Kohëzgjatja e trajnimit: 6 ditë trajnimi për secilën fushë.
- ✗ Kredite: 2

**KOMPONENT 2.** Trajnimi i mësuesve të arsimit fillor në lëndët: *Gjuhë shqipe, Matematikë dhe Dituri natyre* për metodologjitë e mësimdhënies interaktive sipas *qasjes STEM*, si dhe ngritja e kapaciteteve të mësuesve për vlerësimin ndërkombëtar TIMSS dhe PIRLS.

- ✗ Përfituesit: 2500 mësues të arsimit fillor për të gjithë periudhën e programit
- ✗ Kohëzgjatja e komponentit: 2 vjet (2024 – 2025)
- ✗ Kurrikula e përmbledhur e trajnimit: 9 module gjithsej të ndara sipas fushave specifike: *Gjuhë shqipe, Matematikë dhe Dituri Natyre*
- ✗ Kohëzgjatja e trajnimit: 9 ditë trajnimi për secilën fushë.
- ✗ Kredite: 3

**KOMPONENT 3.** Trajnimi i mësuesve të arsimit fillor për përmirësimin e aftësisë së kodimit dhe aftësive digjitale të nxënësve në shkollat e pajisura me SmartLab.

- ✗ Përfituesit: 1340 mësues të arsimit fillor dhe TIK për të gjithë periudhën e programit

- ☒ Kohëzgjatja e komponentit: 2 vjet (2024 – 2025)
- ☒ Kurrikula e përmbledhur të trajnimit: 3 module trajnimi sipas fushave.
- ☒ Kohëzgjatja e trajnimit: 25 ditë trajnimi
- ☒ Kredite: 9

**KOMPONENT 4.** Trajnimi i mësuesve të arsimit të mesëm të ulët për realizimin e sondazhit ndërkombëtar TALIS 2024 për zhvillimin profesional të mësuesve.

- ☒ Përfituesit: 4150 mësues të arsimit të mesëm të ulët për të gjithë periudhën e programit
- ☒ Kohëzgjatja e komponentit: 4 muaj (2024)
- ☒ Kurrikula e përmbledhur të trajnimit: 3 module trajnimi sipas kategorive të mësuesve, drejtuesve dhe koordinatorëve.
- ☒ Kohëzgjatja e trajnimit: 3 ditë trajnimi për secilën kategori.
- ☒ Kredite: 1

**KOMPONENT 5.** Trajnimi i mësuesve të arsimit të mesëm të ulët për larmishmërinë e veprimtarive në lidhje me përmirësimin e orientimit për karrierë të nxënësve drejt arsimit të mesëm.

- ☒ Përfituesit: 10000 mësues të arsimit parauniversitar për të gjithë periudhën e programit
- ☒ Kohëzgjatja e komponentit: 2 vjet (2024 – 2025)
- ☒ Kurrikula e përmbledhur të trajnimit: 2 module trajnimi sipas klasave përkatëse
- ☒ Kohëzgjatja e trajnimit: 6 ditë trajnimi
- ☒ Kredite: 2

**KOMPONENT 6.** Trajnimi i mësuesve të arsimit parauniversitar për përmirësimin e metodologjisë gjatë orës së mësimit në lidhje me teknikat e gjithëpërfshirjes së nxënësve.

- ☒ Përfituesit: 15000 mësues të arsimit parauniversitar
- ☒ Kohëzgjatjen e komponentit: 1 vit (2024)
- ☒ Kurrikula e përmbledhur të trajnimit: 1 modul
- ☒ Kohëzgjatja e trajnimit: 2 ditë trajnimi
- ☒ Kredite: 1

**KOMPONENT 7.** Trajnimi i mësuesve të arsimit parauniversitar për aftësitë efektive të mësuesit: zgjidhja e konflikteve dhe aftësitë e komunikimit.

- ✗ Përfituesit: 4400 mësues për të gjithë periudhën e programit
- ✗ Kohëzgjatja e komponentit: 2 vjet (2024 – 2025)
- ✗ Kurrikula e përmbledhur të trajnimit: 2 module sipas çështjeve përkatëse
- ✗ Kohëzgjatjen e trajnimit: 6 ditë trajnimi
- ✗ Kredite: 2